



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Ministria e Punëve të Brendshme shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm
Institucioni	Ministria e Punëve të Brendshme
Nr. i Referencës	RN00012073
Kodi	RPC0005653
Data e njoftimit	14.07.2023
Afati për aplikim	04.08.2023 - 11.08.2023



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës
- Zhvillon dhe arrinë pëlqimin për planet e punës dhe afatet në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në përputhje me përshkrimin e detyrave të vendit të punës dhe kërkesat profesionale
- Siguron zbatimin efektiv të planeve e aktiviteteve zyrtare që rrjedhin nga përshkrimi i detyrave zyrtare të punës dhe të njësisë organizative;
- Është përgjegjës për të siguruar zbatim efektiv të rregullave e procedurave administrative duke përdorur njohuri të thella profesionale;
- Është përgjegjës për të ndërmarrë masa ekzekutuese apo inicuar raste të shqyrtimit dhe verifikimit të ligjshmërisë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës;
- Është përgjegjës për të ofruar këshillime, rekomandime e udhëzime profesionale të nivelit të lartë e në përputhje me kërkesat ligjore si dhe standardet teknike e profesionale të fushës për të gjitha palët;
- Është përgjegjës për miratimin/konstatimin e korigjimit të shkeljeve të legjislacionit në fuqi dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin nga këto shkelje kur kjo kërkohet me përshkrimin e detyrave zyrtare të pozitës ku emërohet;
- Është përgjegjës për marrjen e masave administrative dhe shqiptimit të gjobave që kanë për qëllim shmangien e rreziqeve që mund t'i shkaktohen të drejtave dhe interesave të ligjshme të qytetarëve, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi përfshirë edhe aktet dytësore normative në fuqi;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimitimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në fushat: Arsim i lartë i paspecifikuar.
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë;
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Nr. i kërkuar
RPC0004722	RN00011072	Inspektor i Tregut	Profesional 1	111-7	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Inspektoriati i Tregut / Prishtinë	27

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim



- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (vërejtje: nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse); Nuk kërkohet dëshmi mbështetëse për përvojën e punës në sektorin publik.
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. Njëra nga këto dokumente është e mjaftueshme;
- Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati/ja nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur);
- Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryerjen e detyrës (prezantohet nëse kandidati/ja përzgjidhet për emërim. Dëshmia duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj); Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;
- Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrtarët Publik.
- Nëse përvoja e punës e deklaruar është në: sektorin privat brenda apo jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetë deklaram i nënshkruar se ai/ajo, nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrtarët Publik.

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Mendim analitik, dëgjues i mirë, shkathtësi për kërkim të fakteve, aftësi të fotografimit të gjetjeve, shkathtësi komunikimi të qartë me shkrim dhe me gojë;
- Njohja e mirë e organizimit të administratës shtetërore të Republikës së Kosovës;
- Njohja e parimeve të procedurës administrative legjislacionit ekzistues;
- Aftësi të interpretimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;
- Njohja e gjuhëve zyrtare, në përdorim;
- Preferohet të jetë specialist i ndonjë prej fushave që adresojnë politiken e tregjeve;
- Shkollimi pasuniversitar është i dëshirueshëm.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Vërejtje me rëndësi:

Formati i dokumentacioni: duhet të jetë VETËM, pdf. Nëse dokumenti ngarkohet në një format tjetër, do të konsiderohet se nuk përmbushet kriteri për dokumentin e kërkuar.

Adresa zyrtare e kontaktit për ndihmë teknike rreth aplikimit:

E – mail: simbni.info@rks-gov.net;

Telefoni: +383 38 200 60 710

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

